

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



Poezia për fëmijë e Naim Frashërit

Punim diplome

MENTORI:

Prof.Ass.Dr.Besim Muhadri

KANDIDATJA:

Miranda Ibrahim

Gjakovë, 2017

Përmbajtja

Hyrje	5
<i>Objekti dhe motivimi i temës</i>	5
<i>Synimi i temës</i>	5
<i>Metodologjia dhe metodat e punës</i>	6
KAPITULLI I PARË	7
Jeta dhe vepra e Naim Frashërit	7
1.1 <i>Jeta</i>	7
1.2 <i>Vepra</i>	8
<i>Veprat në shqip</i>	9
<i>Veprat në turqisht</i>	9
<i>Vepra në persisht</i>	9
<i>Vepra në greqisht</i>	10
KAPITULLI I DYTË	10
Poezia për fëmijë e Naim Frashërit	11
2.1 <i>Poezia</i>	11
2.2 <i>Poezia diturore</i>	12
2.3 <i>Poezia morale</i>	14
2.4 <i>Fabulat</i>	18
KAPITULLI I TRETË	20
Të veçantat e disa poezive të Naim Frashërit	20
3.1 <i>Përdorimi i alegorisë</i>	20
3.2 <i>Përdorimi i epiteti</i>	24
3.3 <i>Pyetja retorike</i>	26
3.4 <i>Lavdërimi</i>	27
3.5 <i>Lutja</i>	28
KAPITULLI I KATËRT	30
Gjuha në veprën e Naim Frashërit	30
4.1 <i>Gjuha poetike</i>	30

<i>4.2Vlera artistike e poezive</i>	30
KAPITULLI I PESTË.....	32
<i>5. Mendime kritike për veprën e autorit</i>	32
Përfundimi.....	34
Bibliografia (Literatura).....	35



NAIM FRASHËRI (1846-1900)

“Jeni të mirë, veti pastër. Doni mëmëdhenë dhe gjuhën tuaj!”

Naim Frashëri

Hyrje

1. Objekti dhe motivimi i temës

Poeti ynë kombëtar Naim Frashëri është figura qendrore e letërsisë shqipe të Rilindjes. Është një nga përfaqësuesit më të shquar të letërsisë shqiptare. Kontributi i tij për krijimin e një gjuhe të pastër shqipe, për edukimin e popullit shqiptar është i madh dhe me vlerë të fuqishme.

Naimi me penën e tij e krijoi një Shqipëri të re. Si një poet i çiltër në të shumtën e rasteve mendimet e tij i shprehi në formën e duhur. Krijimtaria e tij letrare është e rrallë, atë e përcjellë shumëllojshmëria e shkrimeve. Ndër to janë edhe poezitë për fëmijë të cilat do të trajtohen gjatë këtij punimi. Kjo temë është tërheqëse dhe e rëndësishme sepse letërsia për fëmijë është ajo që ndikon në zhvillimin e karakterit dhe të personalitetit të fëmijëve që në moshën e hershme. Këtë temë e kam punuar me pasion dhe dëshirë të veçantë, gjithashtu i jam përkushtuar maksimalisht. Gjatë punimit të kësaj teme i kam lexuar dhe studiuar me shumë kënaqësi poezitë e Naim Frashërit, duke u ndalur te secila për të gjetur elementet të cilat i bëjnë më të veçanta ato. Kam gjetur elemente nga më të ndryshmet brenda magjisë fëmijërore që e krijoi Naimi.

Këto elemente fillojnë me dijen si kushti parësor për zhvillimin intelektual të fëmijëve duke vazhduar me moralin, natyrën, atdheun, miqësinë, ndihmën, mëshirën, lujten e shumë elemente të tjera. Kam ndjerë kënaqësi gjatë kësaj pune shkencore që nuk është e lehtë për t'u realizuar, por gjithashtu kam ndjerë përgjegjësi dhe jam munduar të jem e kujdesshme gjatë trajtimit të saj.

2. Synimi i temës

Ky punim synon të japë një panoramë gjithëpërfshirëse të poezisë për fëmijë të rilindësit tonë të shquar Naim Frashërit. Ai është poet i lindur dhe i përkushtuar gjatë gjithë jetës së tij krijuese. Kjo temë ka meritën e saj të studiohet pasi që krijimet poetike të Naimit për fëmijë janë të parat në letërsinë shqipe. Meritë tjetër e tyre është sepse me to u themelua letërsia shqipe për fëmijë.

3. Metodologjia dhe metodat e punës

Gjatë realizimit të këtij punimi janë përdorur metoda të ndryshme letrare. Është përdorur metoda hulumtuese. Kur themi hulumtuese duhet të nënkuptojmë se çdo punë hulumtuese ka vështirësitë e saj. Jemi munduar të bëjmë hulumtime në literaturat më të reja të sjella nga studiues letrarë të rinj të cilët kanë kontribuar në temën në fjalë. Kemi përdorur metodën analizuese, pasi që realizimi i kësaj teme pa këtë metodë do të ishte i pamundur. Metodën e analizës e kemi përdorur që në fillim të temës, njëherë duke i analizuar sipërfaqësisht poezitë e tij, e në vazhdim duke u thelluar në vargjet e thesarta të Naimit. Është përdorur edhe metoda kërkuese, sepse në të gjitha poezitë e tij është bërë punë kërkimore për të gjetur elemente të veçanta të cilat janë trajtuar në vazhdimësi.

KAPITULLI I PARË

Jeta dhe vepra e Naim Frashërit

1.1 Jeta

Naim Frashëri lindi më 1846, në kohën kur lëvizja jonë kombëtare po njihte manifestimet e saj të para me veprat e Veqilharxhit, De Radës e të tjerëve. Është koha kur marrëdhëniet e popullit tonë me Turqinë po ashpërsoheshin shumë. Frashëri, vendlindja e poetit, ishte një qendër feudal, dikur e fortë, por që tani e kishte humbur shumë rëndësinë e mëparshme. Naimi i filloi mësimet te hoxha i fshatit, në Frashër: mësoi pak turqisht dhe arabisht. Më 1865 familja e tij u vendos në Janinë pas vdekjes së babait. Edhe pse 19 vjeç, Naimi hyri në gjimnazin Zosimea. Këto studime të mesme kanë një rëndësi të madhe për jetën e tij, sepse poeti dhe patrioti i ardhshëm njohu tani letërsinë klasike greko-latine, mori kontakt me kulturën moderne të Evropës¹. Më 1870 Naimi shkoi për të punuar në Stamboll, por e la punën shpejt, pasi gjatë kësaj kohe iu shfaqën shenja të sëmundjes së mushkërive.

Në gjendje të tillë ai u kthye në vendlindje, në Frashër. Klima e shëndetshme ndikoi për të mirë në shëndetin e Naimit. Në vitin 1876 ai u bashkua me të dy vëllezërit Abdylin dhe Tahsimin në Janinë. Atje jetonte me shqetësimin për fatin e Shqipërisë dhe ndiqte me kujdes veprimtarinë politike dhe kulturore të shqiptarëve në botën e huaj. Pas katër vjetësh e dërgoi në Bukuresht poemthin e tij të parë në shqip “Shqipëria”, ku shpalli idetë kryesore të Rilindjes. Vepra ngjalli një admirim të jashtëzakonshëm në radhët e intelektualëve shqiptarë të atjeshëm. Pasi Lidhja e Prizrenit u ndesh me armë kundër osmanëve; Abdyli u arrestua, ndërsa Naimi që jetonte në Janinë u vu nën kontrollin e policisë.

Nga këto kushte ai u shpërngul së bashku me familjen në Stamboll ku jetonte Samiu. Naimi u bë krahu i djathtë i Samiut në organizimin dhe drejtimin e shqiptarëve të atjeshëm, si

¹ Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, *Historia e letërsisë shqipe I-II*, Prishtinë, 1975, f.460, 461, 462, 463.

dhe të atyre në Rumani, Egjipt dhe brenda në Shqipëri². Pasi që Naimi kishte rënë shumë nga shëndeti ai nuk shkruante më që nga viti 1895. Ai vuante nga një laregjitë tuberkularë, që e mundi shumë dhe e rrëmbeu të ri, në moshën 54 vjeçare, më 20 tetor 1900, në Stamboll. Vdekja e Naimit ishte një zi kombëtare. Çajupi e shprehu dhimbjen e tërë popullit në një poezi të shkruar për të:

*“Vdiq Naimi, Vdiq Naimi,
moj e mjera Shqipëri!
Mëndjelarti, zëmërtrimi,
vjershëtori si ai!...
Vdiq Naimi po ç'të gjeti,
o moj Shqipëri e mjerë!
Vdiq Naimi, po kush mbeti
Si Naimi s'ka të tjerë³”*

Këto vargje që Çajupi i kishte thurur për nderë të Naimit si një ndër figurat më të shquara të asaj kohe, janë vargje të thella në të cilat shprehet një melankoli e madhe për vdekjen e tij. Me anë të këtyre vargjeve, Çajupi e portretizon figurën madhështore të Naimit si një njeri unik dhe të plotësuar, si një baba i Shqipërisë së madhe të asaj kohe, si një figurë meritore e lavdishme që nuk do të arrijë të zëvendësohet me shekuj e dekada pas.

1.2 Vepra

Figura e Naim Frashërit u ndrit nga mundi dhe sakrifica që ai e bëri gjatë gjithë jetës së tij. Këtë mund që ai derdhi nga fuqia e mendjes, e dëshmojnë më së miri veprat që ja la pas popullit shqiptar për shekuj me radhë. Veprimtaria e Naimit ishte e larmishme. Përveç veprave në shqip ai ka shkruar edhe në gjuhë të tjera si persisht, turqisht, dhe greqisht. Naimi shkroi vepra në poezi dhe në prozë, në ligjërimin epik, dhe në atë lirik.

² Sabri Hamiti, *Letërsia romantike shqiptare*, Albas, Prishtinë, 2007, f.53.

³ http://letersia.fajtori.com/Letersi/E Rilindjes/Andon_Zako_Cajupi/naim_frasheri.php

Veprat në shqip

1. *Bagëti e bujqësia*, Bukuresht, 1886
2. *E këndimit çunave. Këndonjëtoreja*, Bukuresht, 1886
3. *E këndimit çunave. Këndonjëtoreja*, Bukuresht, 1886
4. *Istoria e përgjithëshme për mësonjëtoret të para*, Bukuresht, 1886
5. *Vjersha për mësonjëtoret e para*, Bukuresht, 1886
6. *Dituritë për mësonjëtoret e para*, Bukuresht, 1888
7. *Lulet e verësë*, Bukuresht, 1890
8. *Mësime*, Bukuresht, 1894
9. *Parajsa dhe fjala flutarake*, Bukuresht, 1894
10. *Gjithësia*, Bukuresht, 1885
11. *Fletore e Bektashinjëve*, Bukuresht, 1896
12. *Iliadh'e Omirit*, Bukuresht, 1896
13. *Istori e Skëndërbeut*, Bukuresht, 1898
14. *Qerbelaja*, Bukuresht, 1898
15. *Istori e Shqipërisë*, Sofje, 1899
16. *Shqipëria*, Sofje, 1902

Veprat në turqisht

1. *Gramatika e persishtes sipas metodës së re*, Stamboll, 1881
2. *Shpikje dhe zbulime*, Stamboll, 1881
3. *Katër sitinët*, Stamboll, 1884
4. *Iliada*. Vepër e Homerit e përkthyer në greqisht, Stamboll, 1886

Vepra në persisht

1. *Ëndërrime*, Stamboll, 1884

Vepra në greqisht

1.*Dëshira e vërtetë e shqiptarëve*, Bukuresht, 1886

2.*Dashuria. Poemë origjinale në tetë këngë të ilustruara*, Stamboll, 1895⁴.

⁴ Sabri Hamiti, *Letra Shqipe*, Dukagjini, Pejë, 1996, f.63.

KAPITULLI I DYTË

Poezia për fëmijë e Naim Frashërit

2.1 Poezia

Për nga ana sasiore në krijimtarinë e Naimit poezia është në numër më të madh se proza. Por për nga ana kuptimore poezia dhe proza kanë ngjashmëri, veçse dallohen dukshëm në një pikëpamje. Dallimi në mes tyre është sepse për kuptimin e poezive fëmijët kanë nevojë për ndihmën e prindërve apo të mësuesve.

Poezitë e autorit i kemi të pranishme në vëllimin “*Vjersha për mësonjëtoret e para*”, vëllim ky që u botua në vitin 1886. Me anë të këtij krijimi poetik Naimi u bë poeti i parë që shkroi poezi për fëmijë dhe vuri themelet e tij në historinë e letërsisë shqipe për fëmijë, ashtu siç bëri histori me poemën e tij për të rritur “Bagëti e Bujqësi”. Përveç vëllimit *Vjersha për mësonjëtoret e para*, ai e botoi edhe përmbledhjen “*Parajsa*” dhe “*Fjala flutarake*” në vitin 1894.

Më tepër se për fëmijët poezitë e tij mund të themi se janë për personat e moshës madhore si prindërit apo vet mësimdhënësit, pasi që vërtetë janë të komplikuar. Këto poezi tematikisht dhe strukturalisht kërkojnë një lodhje psikike për t’i përvetësuar të rriturit, e për fëmijët nganjëherë janë vështirë të përceptueshme. Vjersha “*Fjalët e qiririt*” e cila është e futur në vëllimin e poezive për fëmijë, *Vjersha për mësonjëtoret e para* dhe në vëllimin *Të vegjëlit*, nuk është saktësisht, dhe nuk mund të quhet vjershë për fëmijë. Por jo gabimisht dhe pakujdesisht ajo është futur në këto vëllime.

Vjersha *Fjalët e qiririt* është vjershë e përkushtimit mendor, por edhe atdhetar të Naim Frashërit. Në këtë poezi ai flet për rolin që një vjershëtorë duhet të ushtrojë në një mjedis shoqërorë, por njëkohësisht në të flet edhe për rolin që duhet të ushtrojë vetë në jetën e popullit shqiptarë. Vjersha *Fjalët e qiririt* mund të quhet, prandaj, jetëshkrim mendor, moral dhe atdhetar i Naim Frashërit si vjershëtorë⁵. Vjershëtori është vetë mësuesi i cili te kjo poezi digjet dhe shkrihet si qiriri vetëm për të ndriçuar mendjen e bashkëvendësve të tij. Fjalët e tij janë të fuqishme, motivuese, dhe jetëdhënës. Ato përcjellin shpresë për ditë të ndritshme për një të ardhme të lumtur.

⁵ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Botime Toena, Tiranë, 2000, f.141.

*“Unë zjarrit nuk i druhem
dhe kurrë s’dua të shuhem
po të digjem me dëshirë
sa të mundt t’ju ndrinj më mirë.
Kur më shihni se jam tretur
mos parandehni se kam vdekur:
jam i gjall’ e jam në jetë,
jam në dritët të vërtetë;
unë jam në shpirtit tuaj⁶”*

2.2 Poezia diturore

Naim Frashëri si atdhetar, mendimtar dhe veprimtar i shquar i arsimit e i kulturës shqiptare, rëndësi të veçantë i kushtoi ngritjes diturore të popullit, veçanërisht fëmijëve. Mësimi dhe shkollimi janë dy elemente të qëndrueshme të cilat e përfaqësojnë krijimtarinë e tij. Fëmijët në poezinë e Naimit nuk janë personazhe, ashtu siç janë në prozat dhe në disa nga fabulat e tij. Poezia diturore e tij zë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tij poetike për fëmijë, sepse kujdeset që t’i mësojë, por njëherësh edhe ata ta kuptojnë me qartësi.

Një vend të rëndësishëm në poezinë e tij për fëmijë zë edhe poezia shpjeguese për gjithësinë, për natyrën dhe për njeriun, ose si mund të quhet ndryshe poezia diturore. Në një numër të madh të veprave ai botën e kombinon me gjithësinë. Në poezitë shpjeguese-diturore për natyrën dhe për gjithësinë Naimi kishte zgjedhur një qëllim kryesorë e që ishte: të përhapë e të popullarizojë njohuritë deri në të cilat kishte arritur dija e qiellshikonjës (astronomisë) ashtu si e quante ai në kohën e tij.

Nëpërmjet figurave të kuptueshme dhe të qëllueshme për fëmijë të cilave ju përshtatej psikologjia e tyre, ndjehet të ngulitet dhe të mbahet mend ajo çfarë është e shkruar, dhe mesazhi që kumtohet brenda tyre. Brenda këtyre poezive mund të mësohet për tokën që është trup i rrumbullakët, për diellin që lind çdo ditë, për nxehtësinë e fuqishme që ai e përçon. Këto janë të vërteta diturore të cilat Naimi synonte t’i afronte sa më afër mendjes së fëmijëve.

⁶ Naim Frashëri, *Të vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, fq.5.

Për tokën si trup qiellor thuhet:

*“Dheu është një yll i qjellit,
që lëvrin në hapësirë,
i vjen rreth e rrotull djellit,
mer të ngrysur e të gdhirë⁷”*

Po kështu, përmes figurave mësojmë se toka ka madhësinë e diellit, po ashtu edhe formën e saj të rrumbullakët. Për diellin kuptojmë që lind dhe perëndon, dhe se këta dy trupa qiellorë janë në lëvizje të përhershme rreth njëri-tjetrit.

*“Diellin e ka atë,
e hënë e ka bijë,
bashkë me ta dit' e natë
rron si ç'është një fëmijë⁸”*

Duke e vënë në objekt të poezisë së tij familjen, Naimi i jep gjallëri dhe emocion të papërshkrueshëm asaj. Me anë të treshes babë, nënë, dhe bijë ai e ndërton poezinë dhe e bënë dukshëm të kuptueshme atë, sepse i zëvendëson emrat më të dashur familjar me trupat qiellorë. Ai mundohet që fëmijët ta përvetësojnë atë logjikisht dhe sa më lehtë, por edhe ta ndiejnë dhe ta jetojnë sa më thellësisht.

Përveçse për trupat qiellorë prej vjershave shpjeguese-diturore të Naim Frashërit mund të mësohen njohuri edhe për një numër të madh të dukurive natyrore psh: se si krijohet shiu, bora, bryma, si fryn era, rrufeja; se si krijohen lumenjtë, liqenet, detërat; se si toka ndahet në kontinente; se cilat janë kontinentet, se si është krijuar njeriu prej kafshës, se si njeriu së pari ka filluar të merret me bujqësinë; se si ka filluar të punoj me metale, e të tjera. Prej këtyre vjershave shpjeguese-diturore mund të mësohet se cilat janë rasat e njerëzve, se si njeriu ka mësuar të flas

⁷ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.17.

⁸ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.17.

dhe të bëjë disa punë të veçanta; se si ka mësuar të këndojë; se si është bërë qenie shoqërore; se si është bërë krijesë krenare⁹.

Të gjitha këto mësimë me anë të poezisë ai mundohet që t'ua mësojë fëmijëve dhe ta ndritë në një formë apo në një mënyrë tjetër mendjen e tyre, t'ua zhvillojë kufijtë e imagjinatës dhe t'ua hap horizontin e dijes. Kështu, në vjershën *Dituritë*, ai tregon se populli shqiptar është ndër popujt më të lashtë që erdhën nga India dhe zunë vend në kontinentin evropian. Poezia shpjeguese-diturore e Naimi Frashërit është poezi e një rëndësie të veçantë sepse ato tema jo të pakta që ai i hodhi në vargje ishin vetëm mendime të librave fetarë në atë kohë. Shumë shpesh vihet në pikëpyetje poezitë diturore të tij, disa i quajnë mendime të gabuara, por përgjithësisht ato janë mendime diturore të cilat janë pjesë po ashtu e ditëve të cilat ne po i jetojmë në shekullin tonë. Një gjë vihet re në vjershat shpjeguese-diturore të Naimit, e ajo është përmendja në shumë raste e Perëndisë si krijues i gjithësisë.

Perëndia për të duket se është formë e fuqishme me anë të së cilës mundohet të ndikoj në zhvillimin moral dhe mendor të fëmijëve. Poezinë diturore ai e shkroi për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve në veçanti, por poezinë morale duket sikur e ka shkruar për ngritjen morale të njerëzisë në përgjithësi.

2.3 Poezia morale

Temat me përmbajtje morale janë të shpeshta në përgjithësi në krijimtarinë e Naim Frashërit. Në poezitë morale të Naimit hyjnë vjershat *Fjala*, *Mejtimi*, *Njerëzia*, *E vërteta*, gjithashtu *Fjalët e urta* dhe *fabulat* e përshtatura nga La Fonteni, por edhe ato të cilat i shkruan vet, në përmbledhjen *Vjersha për mësonjëtoret e para*. Na lindë pyetja se çfarë deshi Naimi të zhvillojë me anë të këtyre poezive morale të fëmijëve? Natyrisht se morali është kushti parësorë për personalitetin e njeriut, në përgjithësi morali është ndër gjërat më të shtrenjta që na lidhë me jetën tonë. Sipas Naimit, njeriu i mençur dhe i ditur është një njeri i kompletuar moralish. Në vjershën e tij *E vërteta*, ai dëshiron t'u mësojë fëmijëve një të vërtetë.

Të vërtetën se Zoti ju ka dhuruar sy, mendje, shpirt dhe zemër e për të cilat duhet të jenë mirënjohës. Zoti i dha mundësi njeriut që me anë të tyre ta njeh botën. Me sy ta shikojë, me shpirt ta vlerësojë dhe me zemër ta ndiejë. Të gjitha këto ndjenja do t'i kuptoj nga vetja e tij me

⁹ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Botime Toena, Tiranë, 2000, f.145.

ndjenjat e tij, dhe do t'i vlerësoj në mënyrën më të drejtë dhe me mendje atëherë kur ai është i ditur, e atëherë kur nga mënyra e të vlerësuarit do të dallojë vetën nga një njeri i paditur:

*“Vëre re mirë njerinë,
T’i njohç Zotit urtësinë,
I dha sythit që të shohë
Mëndje të lartë të njohë.
Shpirtinë, që të gjykonjë,
Zëmrënë, kë të peshonjë,
Njohënë, që ka dëshirë
Për të drejt’ e për të mirë.
S’ka më të lartë në jetë
Nga njeriu, q’është i vërtetë,
Se njeriu munt të mësonjë,
Të gjitha t’i kuptonjë¹⁰”*

Kur njeriu do arrijë t'i kuptoj dhe t'i vlerësojë të gjitha këto te njerëzia, padyshim do të jetë falënderues edhe te Perëndia, sepse do t'i njoh më mirë mirësitë e tij. Po ashtu në vargjet e poezisë *E vërteta*, Naimi jep një frymë optimizmi dhe shtyese për të mësuar, sepse ai kumton se: njeriu mundet të mësojë, mjafton të ketë dëshirë dhe vullnet. Në vazhdim ngrit vlerën e njeriut të ditur dhe të drejtë në shkallën më të lartë që ndodhet në jetë, për dallim nga një njeri tjetër i paditur që në vargjet e tij nuk e dallon shumë prej kafshës.

*“Njeriu q’ë është i pamsuar
nga kafshët s’është i ç’quar¹¹”*

Fjalëtë e të urtët, është poezi morale ku shprehet dashuria që fëmijët duhet të kenë për familjen, dhe për njerëzinë. Dashuria është një ndjenjë njerëzore që duhet të jetë në çdo shpirt të

¹⁰ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.95.

¹¹ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.24.

njeriut, sepse më me vlerë është një shpirt i mbushur me dashuri, se një shpirt në të cilin pushon urrejtja. Naimi, vjershëtori i madh i popullit tonë këtë të vërtetë morale e shprehu mjaft bukur në vargje, kur thotë se dashuria duhet bërë zakon, sepse zakonet vështirë humben.

*“Duaj atën’ edhe mëmën,
Të jeshë fatbardhë në jetë,
Se po të t’apinë nëmën,
Kurrë nukë bën përpjetë.
Duaj motrën duaj vëllanë,
Bëjë zakon dashurinë,
Duaj atë, që ke pranë,
Edhe gjithë njerëzinë¹²”*

Bamirësia është njëra prej gjërave të rëndësishme të personalitetit të njeriut, po ashtu edhe për Naimin si shkrimtar. Ai bamirësinë e vleron në shumicën e shkrimeve të tij sidomos në prozën dhe poezinë e tij për fëmijë, po ashtu edhe në fabulat.

Bamirësinë dhe kuptimin e saj sipas vargjeve të Naimit fëmijët duhet ta mësojnë qysh në moshën e hershme të tyre, dhe të rriten me këtë ndjenjë në shpirt, dhe atëherë kur kanë mundësi, të ndihmojnë ata që kanë nevojë. Mirësia është një urë mes njerëzisë me të cilën ndërtohet dhe lidhet lumturia e përbashkët .

*“Duhet që nga vogëlia,
bërë zakon mirësia¹³”*

Në fjalët e të urtëve, bamirësia arrin deri në ndjenjën e mëshirës, sepse ai thotë se nëse nuk mundemi ta ndihmojmë të varfërin me gjëra materiale, së paku ta bashkëndejmë dhimbjen e tij dhe ta qajmë hallin së bashku. Një lot për Naimin, është më i vlefshëm se sa një zemër e

¹² Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.12.

¹³ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.70.

ngrire. Me anë të këtyre vargjeve, mundohet të lë të kuptojnë fëmijët që duhet ta bashkëndejnë dhimbjen e njeriut nevojtar.

*“Në mos ke, e në mos ep dot,
Për të mjerë lësho një lot¹⁴”*

Naim Frashëri në vargjet e tij përçmon njeriun i cili nuk e mban besën, atë që gënjen, atë që i përton punës, atë që nuk e pranon fajin kur është vetë fajtorë e shumë dukuri të tjera. Sipas pikëpamjeve të Naimit, njeriu është sjellja e tij, ajo e përcakton atë. Një njeri që nuk e do punën, është një njeri që jeton me vese të këqija. Prej punës varet dituria edhe personaliteti i njeriut. Prandaj ai është i bindur se përmes punës fëmijët mund të bëhen të vyeshëm për familjen, njerëzinë, dhe për popullin.

Puna për të është gjithçka e mirë që të lartëson, dhe të largon përgjithmonë nga ultësia dhe pandershmëria, nga veset dhe të ligat. Fuqia e poezisë morale të tij nuk ndalet pa prekur edhe temën e atdhedashurisë, me të cilën ishte i lidhur ngushtë. Kësaj ndjenje i kushton rëndësi dhe vlerë te veçantë duke qenë vet mësues i popullit. Janë të pakta ato vjersha atdhetare të Naimit për fëmijë, por janë të shumta vargjet në të cilat ai e përmend atë:

*“Njeriu po s’deshi kombin e tij
e mëmëdhenë,
nuk ka pjesë nga njerëzia
s’do as veten¹⁵”*

Me anë të këtyre vargjeve Naimi u thotë fëmijëve se një njeri që nuk e do kombin e tij, mëmëdhenë e tij nuk e do as veten e tij. Kaq vlerë të madhe ka për të atdheu sa në çdo mënyrë mundohet që fëmijëve t’ua vë në dijeni, dhe mos t’i lë që atdhedashuria të jetë temë e cila do të mbetet në harresën e tyre, sepse ata duhet të rriten me këtë ndjenje të fuqishme dhe të rëndësishme të cilën e kishte edhe ai në shpirt dhe në mendje.

¹⁴ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.32.

¹⁵ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.56.

Naim Frashëri përpiqet për një edukim të ri të fëmijëve, në të vërtetë për një edukim të fëmijëve, që do të mbështetet në dituri dhe jo në fe. Dhe, a mund të përpiqej ndryshe ai në atë kohë? Pa dyshim jo. Në atë kohë të përpjekjeve të shkrimtarëve shqiptarë, si paranojë shpirtërore e popullit, për ndërtimin e ndërgjegjes kombëtare mbi mëvetësinë etnike, mbi traditën historike e jo kulturore e jo mbi përkatësinë fetare: në atë kohë të përpjekjeve të tyre që mbi përkatësinë fetare ende të fortë të vënë, pra, përkatësinë kombëtare, dija është mjete më i rëndësishëm më të cilin mund të luftohen paragjykimet fetare dhe me të cilat mund të ndërtohet morali i njeriut të ri¹⁶.

2.4 Fabulat

Këto konsiderohen ndër krijimet më të bukura të Naim Frashërit dhe janë mjaft të këndshme për lexuesit e vegjël. Te përmbledhja *Vjersha për mësonjëtoret e para* përfshihen 23 fabula. Këto i botoi së pari gjatë vitit 1885, në revistën *Dituria*, në një rubrikë të veçantë me okeilo “E vërteta ndër përralla”. Më tej, në vitin pasues ato hynë edhe në përmbledhjen që përmendëm. Burimi i këtyre fabulave nuk përmendet nga autori. Sipas studiuesve tanë del se këto janë më së shumti nga gurra e fabulistit të madh francez La Fonten, po edhe nga ajo e Ezopit. Madje për ndonjërin prej tyre çështja del e hapur. Mundet që disa të jenë edhe nga burimet e folklorit shqiptar ose edhe nga fryti i imagjinatës së poetit tonë kombëtar. Fabulat e Naimit shprehin protestën kundër shtypësve, padrejtësive shoqërore dhe dënojnë moralin e kalbur.

Një pjesë e mirë janë shkruar plot dinamizëm dhe me gjuhë të përshtatshme, si: *Dimri e vera*, *Kunadhja e veshur si këndes*, *Ujku dhe qengji*, *Dragoi dhe ujku*, *Qeni dhe hieja e tij etj.* Nga shtjellimi i subjektit, shumë prej tyre të kujtojnë motivet e përrallave popullore shqiptare. Karakteristikë e këtyre fabulave është origjinaliteti i tyre. Naimi në to ka shumë tipare, elemente e detaje që nuk i hasim në fabulat e burimit. Pra, poeti ynë ka bërë një punë me të vërtetë krijuese në to. Ai merr nga burimi disa detaje a elemente dhe i përpunon e i zhvillon këtej në mënyrën e vet, të të shprehurit, me stilin e tij individual, me talentin e tij poetik.

Fabulat e Naimit i përshkon e njëjta atmosferë poetike që i shquan vjershat e tjera origjinale të tij. Të bie në sy në to edhe fryma romantike e jetës. Qëllimi i autorit në fabula nuk është vetëm didaktik e moralizues. Si mjeshtri La Fonten, edhe Naimi përpiqet së pari të na jap

¹⁶ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Botime Toena, Tiranë, 2000, f.151.

një krijim të bukur artistik. Te fabulat e Naimit në përgjithësi zotëron karakteri narrativ. Veç ka edhe të tilla ku aksioni zhvillohet pa komente dhe pa ndërhyrjen e autorit, dhe këto janë nga krijimet më të bukura. Përmendim, për shembull, fabulën e mësipërme, *Ujku dhe qengji*, e ndonjë tjetër. Fabulisti ynë i paraqet personazhet në kushte natyrore: në pyje, livadhe etj. Ja si fillon fabula te *Dy qetë dhe ujku*:

*“ Ishte një fushë me lule shumë,
nëpër mes të saj shkonte një lumë...”*

Fryma popullore është mjaft e pranishme në këto fabula. Autori përdor lokocione apo frazeologji të popullit. Edhe fillimi i tyre shpesh është si në përrallat tona popullore, pa zgjatje, por duke përshkruar mjedisin ku do të zhvillohet ngjarja. Fabulat e Naimit janë krijime poetike pothuajse origjinale.

Poezitë për fëmijë të Naim Frashërit kanë veçori edukuese. Kjo është zotësia e tyre ideoemocionale, por nga ana tjetër, është edhe e meta e tyre artistike. Gjuha është gati nacionare. Shprehja deklarative dhe mbingarkesa mësimore e moralizuese, sikur i lë pa pozitë vjershat e tij për fëmijë. Ai nuk kujdeset në vjersha që qëllimet e tij morale e edukative t'i sendërtojë përmes situatash, përfytyrimesh e figurash. Nuk i sendërton ato mbi një motiv që është aq i rëndësishëm në jetën e fëmijës: mbi motivin e lojës.

Për këtë arsye Frashëri nuk mund të quhet vjershëtorë që e kupton mirë psikologjinë e fëmijës, nxjerrë si konkluzion nga Prof. Rexhep Qosja. Përrjashtim thotë ai bëjnë fabulat. Pra, vjershat për fëmijë të Naim Frashërit kanë më tepër rëndësi historike. Me to fillon lëvrimi i poezisë shqipe për fëmijë. Naimi e ka pasuruar këtë letërsi si me larminë e përmbajtjes, ashtu edhe me larminë e trajtave poetike. Por në kohën kur u shkruan këto poezi, letërsia për fëmijë nuk kishte ndonjë traditë të zhvilluar as në Ballkan e as në Evropë. Naim Frashëri në letërsinë shqiptare për fëmijë ka meritën e themelimit të saj¹⁷.

¹⁷ Prof.as.Dr.Astrit Bishqemi, *Histori e letërsis Shqiptare për fëmijë*, Sejko, Elbasan, 2004, f.59,60, 61.

KAPITULLI I TRETË

Të veçantat e disa poezive të Naim Frashërit

3.1 Përdorimi i alegorisë

Alegoria është një formë e shpeshtë e shprehjes së mendimeve në veprat letrare dhe në të folurit e përditshëm. Shumë nga krijimet artistike në tërësi janë alegorike- mendimet thuhet në kuptim të kundërt dhe të fshehtë. Alegoria ka një ton përqeshës dhe kritik. Me këtë figurë ndërtohen fabulat, ku kafshët zëvendësojnë njerëzit, marrëdhëniet dhe veprimet e tyre zëvendësohen me marrëdhëniet dhe veprimet që kanë njerëzit e tjerë.

Në poezitë e Naim Frashërit për fëmijë përdorimi i alegorisë është i dukshëm. Në poezinë *Shkëndij'e diellit ndaj manushaqes* kemi vargjet filluese të vjershës ku bie në sy përdorimi i saj:

*“Manushaqë bukuroshe,
Pse s’e ngre kryet përpyetë,
Po rri e mpit’ dhe’ e qetë,
Pse s’zbukuroh’e’shëndoshe?”¹⁸*

Manushaqja në vargjet e kësaj poezie është alegorizuar me Shqipërinë, e cila është kokulur e shëmtuar dhe e dobët. Tërthorazi ne kuptojmë se gjendja e saj është e mjerë. Në vargjet vijuese të kësaj poezie përsëri është përdorur alegoria:

*“Shpendëra, hitha e ferra
Përsipër të kanë rënë,
Dritënë ta kanë zënë
Me fletë shumë të gjëra”¹⁹*

Shpendërat, hithat e ferrat janë armiqtë që i janë kanosur Shqipërisë dhe po përpiqen ta sundojnë. Hithrat dhe ferrat janë edhe bashkëpunëtorët shqiptarë të cilët punojnë fshehurazi në

¹⁸ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.8.

¹⁹ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.8.

interesin e sundimtarëve osmanë. Ata po e vënë në errësirë Shqipërinë dhe nuk po lënë që të depërtoj tek ajo drita dhe të mirat.

Vjersha *Dhelpëra dhe Lejleku* fillon me vargjet alegorike:

“Dhelpërës një kockë i kishte mbetur

Në gryk, e kishte rënë e mekur.

Lejleku e pa dhe qepn e përpoqi,

Zbriti, ja zuri kockën ja hoqi²⁰”

Brenda këtyre vargjeve Naimi me dhelpër nënkupton njeriun dinak. Ndërsa me lejlekun njeriun bamirës dhe të sinqertë i cili e ndihmon atë. Kocka është një problem apo vështirësi të cilin ai e ndihmoi ta zgjidhte, dhe pas zgjidhjes ose pas kalimit të vështirësisë njeriu dinak e sulmon përsëri, dhe nuk është mirënjohës ndaj tij. Në këtë mënyrë alegorike Naimi ka shprehur marrëdhëniet mes njerëzve.

“Gjinkalla mbetur fort shum’ e gjorë

Erdhi te miz’ e dheut:

Më huaj, gjë, se jam pa ngrënë,

Pa zoti ta çpërblen,

Neve të dy miq po kemi qënë²¹”

Këto vargje me kuptim alegorik i kemi te vjersha *Gjinkalla dhe miz’ e dheut*. Alegoria shpreh në to gjendjen e njeriut punëtor dhe njeriut dembel. Gjinkalla gjatë kohës së verës nuk kishte siguruar ushqimin dhe kishte ngelur e uritur. Ajo kërkon ndihmë te miza e dheut e cila kishte punuar gjatë gjithë verës për periudhën dimërore. Në momentin që kishte ngelur pa ushqim kishte gjetur edhe kohë për t’i treguar për miqësinë që ekzistonte në mes tyre. Pra mund të kuptojmë se në rast nevoje dhe për shkaqe interesi njerëzit e kujtojnë miqësinë që ndoshta për një kohë te gjatë e kishin harruar.

²⁰ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.42.

²¹ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.42.

Vjershëtori jonë i shquar nuk lë pa e prekur edhe temën e lakmisë në mënyrë alegorike. *Breshka me shkabën*, është ndër krijimet poetike të shumta për fëmijë në të cilat personazhe janë kafshët. Me anë të tyre shprehen marrëdhëniet në mes të njerëzve, dhe veprimet të cilat i bëjnë ata. Në të shumtën e rasteve veprimet e pamenduara, lakmia e tepërt janë shkaqe të dështimeve që ndodhin në jetë. Alegorinë në këtë poezi e kemi në vargjet:

“ Breshka shkabësë i thoshë:

Të lutem të më mësos

Kështu si të fluturonj

E në erë të qëndronj”

I tha shkaba je në ment?

Mos e thua kët kuvënt!

Ti je bërë për në dhe,

Jo për erë e për në re²²”

Njeriu nganjëherë kërkon që të mësojë të bëjë një punë të pamundur vetëm që të bëhet njeri i lartë në sytë e të tjerëve. I zhytur në lakmi kërkon nga të tjerët përvetësimin e saj, ashtu si breshka që kërkoi prej shkabës ta mësojë që të fluturojë por më pas e pësoi shumë keq.

“Edhe shkaba e rrëmbëu,

E ngriti shumë nga dheu,

Gjer në qiej fluturoi.

Dhe s’andejmi e lëshoi.

Nuk ran në ndonjë shur,

Po në një të shkretë gurë.

Fort rë lartëkush kërkon

Më së fundi e pëson²³”

²² Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.51.

²³ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.51.

Kështu në fund të poezisë na jepet një mesazh, i cili në mënyrën më të përsosur e përmbledh të gjithë poezinë. Njeriu nuk duhet të kërkojë të arrijë shumë lartë sepse mund të dështoj në jetë, sepse edhe përpjekjet e një njeriu për të të ndihmuar nuk do të kenë sukses kur të mungojnë aftësitë personale, trupore dhe mendore.

E mira dhe e liga nuk mbeten pa u alegorizuar në shkrimet e Naimit. Temat të cilat ai i trajton në mënyrë të fshehtë në vargjet e tij janë të shumta, tema këto të cilat fatkeqësisht ishin pjesë e kohës ku ata jetonin. E mira nuk shpërblehej me të mirë, ndërsa e liga zotëronte një pjesë të madhe të njerëzisë. Populli i cili ishte në shtresë të ulët në shumë raste me mundësit e vogla që i kishte i ndihmonte të tjerët, por ajo që u kthehej ishte vetëm smira. Këtë të vërtetë më së miri e kishte shprehur Naimi në poezinë *Përçollaku dhe breshka*:

*“Breshka më qafë s’e mori,
Po përtej lumit e nxori.
I tha:” Unë t’u ndothçë mik,
Sado q’e ke shpirtin e lik.
Mua më shpëtoi samari,
Po ti do t’vdeç, nga nakari²⁴”*

Breshka e ndihmoi që ta kalonte lumin, duke e ditur që përçollaku dëshironte ta dëmtonte por “samari” që e shpëtoj atë ishte mirësia që ajo i bëri. Kështu një njeri që bënë mirë gjithmonë do të jetë i mbrojtur, sepse e mira asnjëherë nuk humbet, por e keqja që gjendet në shpirtin e njeriut e shkatërron atë.

Një nga arsytet që Naim Frashëri e krijoi alegorinë ka qenë pamundësia për të folur hapur e për ta thënë të vërtetën, sepse në kohën kur ai i shkroi këto krijime alegorike gjendja në Shqipëri ishte e mjerueshme, prandaj ai e kishte parë të nevojshme që në një formë apo në një tjetër të hapë sytë dhe mendjen e fëmijëve përballë dukurive famëkeqe të kohës.

²⁴ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.37.

3.2 Përdorimi i epiteti

Në krijimtarinë letrare për fëmijë të Naim Frashërit përveç alegorisë të cilën e hasim në shumë prej poezive të tij, epiteti është një nga figurat tjera e cila gjithashtu i zotëron një pjesë të mirë të tyre. Duke ju dhënë ngjyrim emocional dhe duke i bërë ato më interesante dhe të kuptueshme për botën e fëmijëve.

Epiteti është një fjalë përcaktuese, zakonisht mbiemër, që i shtohet një emri për t'i pasuruar kuptimin, duke i dhënë bukuri artistike, duke shprehur një vlerësim, një qëndrim nga autori, ose duke i vënë në dukje një anë.

Në poezinë *Bilbili* kemi epitete të cilat i dallojmë dukshëm gjatë leximit:

*“Hëna plot pesëmbëdhjetë
N’anët të qiellit po ndrin’
Bota është gjith’ e qetë,
Gjësende nuk pipërin.*

*Qielli është’i qëruar,
I kulluar posi ari,
I fjetur e i qetuar,
Syri s’nginjetë së pari²⁵”*

Fjalët epitete në këto dy strofa të poezisë janë: *Bota është gjith’ e qetë, Qielli është’i i qëruar, i kulluar posi ari, i fjetur dhe i qetuar*. Në vargjet tjera të kësaj poezie kemi edhe epitet: *e qetë, e bukur, e mirë, i artë*.

Janë epitete sepse bota asnjëherë nuk është e qetë ajo gjithmonë është në lëvizje dhe asnjëherë asnjë qenie tokësore nuk mund ta kontrollojë qetësinë e saj. Qielli a mund të jetë i qëruar në realitet, apo a mund të jetë i kulluar porsi ari? Natyrisht që jo. Qielli nuk fle as nuk qetohet, por duke i përdorur këto epitete Naimi vjershën e ka pasuruar artistikisht, dhe me anë të tyre ka krijuar në imagjinatën e fëmijëve bukurinë qiellore.

²⁵ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.13.

Epitet gjejmë edhe në poezinë *Mejtimi*:

*“Rri mejtohem shumë herë
Tek perndon yll’i zjartë,
Edhe hapet një derë.
Soje rrjeth një drit’e artë.
Retë nga pak e nga pakë,
Marrën një tjetër fytyrë,
Bëhen të kuqe flakë,
E deti ndrin si pasqyre²⁶”*

Yll’i zjartë, drit’e artë, të kuqe flake janë epitete që gjenden në vargjet e para të kësaj poezie. Qetësia shpirtërore të mbërthen gjatë leximit të këtyre vargjeve. Janë të krijuara aq bukur sa të dërgojnë në imagjinatë, në një natë të qetë, të vetmuar me shikim nga qielli.

Është një poezi melankolike e përcjellë me rimë të puthitur ab-ab dhe me intonacion të ndryshueshëm. Ylli i zjarrtë që është epitetizuar duket sikur është njeriu që e rrëmben vdekja dhe perëndon si një yll i zjarrtë, i ndjeshëm dhe plot jetë.

Dera që hapet dhe lëshon dritën e artë na lë të kuptojmë parajsën. Ndërsa retë e kuqe flakë kanë një simbolikë tjetër, sikur përshkruajnë një fytyrë të pajetë të mekur në këtë botë. Në vargjet e mëtutjeshme të saj kemi edhe epitete të tjera si: *të bukura, i veshur, i qetë, i gjerë*.

*“Gomar’ e egër ujku e ndiqte,
Donte ta hante, zemrën t’i diqte,
Gomari me vrap sa mundi nxitoj,
Nga dit’ë e zezë i gjori shpëtoj,
Vate, u psheh nëpër ca gjethe,
Në zemër kishte shtatë pal’ethe²⁷”*

²⁶ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.75.

²⁷ Naim Frashëri, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f.71.

Këto vargje janë marrë në poezinë *Gomar i egër dhe i buti*, epitete në to janë: *Gomar e egër, dit'ë e zezë*. Gomari i egër epitetizohet kështu sepse veprimet e tij janë të ashpëra. Dita nuk është e zezë por e zeza e ditës është e liga apo fatkeqësia e cila ndodh brenda saj. Kjo poezi është me rimë ab,ab të puthitur, fjalët janë me një intonacion të përsheptuar dhe kjo vërehet gjatë leximit të saj.

3.3 Pyetja retorike

Në vargjet e poezive për fëmijë të Naim Frashërit na bie në sy përdorimi i pyetjes retorike. Për shkak të trajtës dhe të intonacionit të tyre, pyetja retorike tregon edhe më qartë sesa është emocionalisht i tendosur ligjëruesi dhe se sa do të donte ta tendoste edhe lexuesin e tij. Pyetja retorike i drejtohet lexuesit, por të cilit nuk i jepet mundësia të përgjigjet, sepse përgjigja është e nënkuptuar: e jep në heshtje ligjëruesi vetë, kurse lexuesi duhet ta marrë me mend²⁸. Pyetjen retorike e kemi në strofën e parë të poezisë *Shkëndij' e diellit ndaj manushaqes*:

*“Manushaqe bukuroshe,
Pse s'e ngre kryet përpetë,
Po rri mpit'edhe e qetë,
Pse s'zbukuroh' e s'shëndoshe?”²⁹*

Me anë të kësaj pyetje ai i drejtohet Manushaqes, edhe pse e di se manushaqja nuk do t'i përgjigjet, por nga përmbajtja e saj lexuesi e di se nuk është fjala për manushaqen “lule” sepse lulja nuk ka zë të flas por me anë të saj Naimi si narrator i drejtohet objektit të cilin ai e trajton brenda në përmbajtjen tematike të krijimit të tij poetik.

*“Qiej, yj e dhe, pushoni,
Tani juve kush u dëgjon?”³⁰*

Edhe në këto vargje të poezisë *Bilbili* e kemi të pranishme pyetjen retorike. Qielli dhe yjet janë të heshtur gjithmonë, por si flasin ata në imagjinatën e Naimit? Qielli, yjet dhe dheu

²⁸ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Botime Toena, Tiranë, 2000, f.280.

²⁹ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.8.

³⁰ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.15.

duket sikur janë persona të cilët dikur kishin rendësi të madhe dhe të lartë por që tani u ka humbur vlera dhe askush nuk dëshiron t'i dëgjojë. Në krijimtarinë e Naim Frashërit pyetja retorike ngjallë emocion të veçantë te lexuesi, sepse është thellësisht e ndjeshme. Duke i pasur parasysh krijimet e tij poetike për fëmijë të cilat janë më të thjeshta se kryeveprat e tij, pyetja retorike në to është më e lehtë për t'u konceptuar.

3.4 Lavdërimi

Ligjërimi lavdërues në krijimtarinë e Naim Frashërit është i shprehur edhe në poezitë e tij për fëmijë. Duke filluar nga Naum Veqilharxhi shkrimtarët shqiptarë shkruajnë shkrime me tema të ndryshme në të cilat lavdërojnë në mënyrë të veçantë dhe duke i zbukuruar personazhet e veprave të tyre. Naimi shkruan me një forcë të veçantë artistike dhe emocionale veprat e tij në të cilat përdorë lëvdatat. Në poezinë e tij *Të vegjëlit*, kemi vargjet lavdëruese në të cilat ai për fëmijët thotë se janë si lulet në jetë:

*“Porsi lulet në jetë,
Q’u ngjajnë nga miturija³¹”*

Në këtë mënyrë Naimi përdorë ligjërimin lavdërues për fëmijët, por nuk janë këto vargjet e vetme lavdëruese të tij. Ai lavdëroi me një përkushtim të madh dhe të shenjë figurën heroike të Skënderbeut. Duke i hiperbolizuar të bëmat e tij, ai e bënë më interesante dhe më magjike poezinë e tij të titulluar ”Skënderbeu.”

*“Njerin’ e kalin e çante,
Të dy me katër i ndante!
Mirësin’ e trimërinë,
Me mendjen e urtësinë
S’e ka pasur nonjë burrë.
Vet’ aty burr’ e trim ishte³²”*

³¹ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001 ,f.27.

³² Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.10,11.

Naimi lavdëroi edhe prejardhjen shqiptare të cilën e kemi nga pellazgët, dhe i përshkruan si një popull të lashtë me traditë dhe me vlerë. Ai lavdëroi bukurinë e gjuhës shqipe, natyrën të cilën nuk e lë pa e përshkruar në vargje. Popullin e cilëson si një ndër racat më të bukura në Ballkan.

3.5 Lutja

Lutja është pjesë e poezive për fëmijë të Naimit. Me anë të kësaj trajte ligjërimore ai synon t'i përvetësojë ndjenjat dhe mendjen e fëmijëve. Lutja dhe urimi janë pjesë e pandashme e njëra-tjetrës, sepse nëse e përdorim lutjen, do ta përdorim edhe urimin. Pothuajse në të gjitha krijimet e Naim Frashërit është përdorur lutja. Ai lutjet më të shpeshta në poezitë e tij për fëmijë ja drejton Perëndisë:

“Zot i math e i vërtetë!

N'atë sy kurrë mos shtjerë

Lot'n e hidhur e të shkretë

Dhe mos e lërë të bjer³³”

Këto vargje janë marrë nga poezia *Të vegjëlit*. Në këto vargje Naimi Frashëri shpreh lutjet e tij te Zoti që fëmijët të mos jenë asnjëherë të mërëzitur. Gjithashtu në këtë poezi ai lutet që fëmijët të jenë të shëndoshë, të mos kenë brenga, të kenë jetë të gjatë, e shumë lutje të tjera. Lutjet i kemi edhe te poezia *Varfëria*, aty ku i përshkruan të pasurit, dhe ju lutet që të japin pak nga të shumtit që e posedojnë, për të varfrit.

“Oh epni, ju që kini,

Kush i ndih varfërisë,

Ay q'ep po e dini,

Q'i huan perëndisë...³⁴”

Po ashtu, Naimi ju tregon se nëse ata do i ndihmojnë edhe Perëndia do t'i shpërblejë për bamirësi. Nuk ka dyshim se lutja është trajtë ligjërimore e parapëlqyer në krijimtarinë e Naim

³³ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.28.

³⁴ Naim Frashëri, *Të Vegjëlit*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f.31.

Frashërit edhe për shkak se me të vetvetiu vihet në dukje rëndësia e përmbajtjes dhe porosisë së saj. Me të, më dukshëm se me trajtat ligjërimore tregohet butësia e ligjëruesit në marrëveshje me lexuesit e tij. Për këtë arsye ajo mund të çmohet si trajtë më demokratike, dhe njëkohësisht, më ndikuese e ligjërimit në krijimtarinë e Naim Frashërit³⁵.

³⁵Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Botime Toena, Tiranë, 2000, f.280.

KAPITULLI I KATËRT

Gjuha në veprën e Naimi Frashërit

4.1 Gjuha poetike

Gjuha e përdorur në poezitë e tij nuk është e sforcuar dhe e ngarkuar me neologjizma dhe barbarizma ose me terminologji të tjera por qëndron e vendosur në suazat e thjeshtësisë. Disa nga neologjizmat që i hasim në vjershat e tij për fëmijë janë: *gjithësi*, *hapësirë*, *vjershëtor*. Gjuha e pasuruar me figuracione dhe me natyrshmëri është rrjedhë e vargjeve dhe bazë e fortë e shkrimeve. Naimi fjalët që i ka përdorur brenda vjershave i ka hulumtuar, modifikuar, krijuar e rikrijuar për t'i paraqitur ato fjalë të cilat i përshtaten më mirë dhe kuptohen më qartë. Intonacioni, rima dhe ritmi i përcjellin këto poezi duke ndryshuar në shumë raste. Gjuha në poezitë e tij për fëmijë ngërthen në vetvete elemente të dijes, kulturës dhe të atdheut, ajo është gjithmonë në shërbim të popullit shqiptarë dhe idealeve përparimtare të tij. Ai me gjuhën e tij poetike synoi që ta bashkojë kombin e tij, ta lartësojë në pikëpamje morale dhe kulturore. Jo më kot ai nuk thotë se “*gjith njerëzit që flasin një gjuhë janë vëllezër*”. Gjuha e përdorur në krijimet e tij poetike është shumë e ngjashme me gjuhën e sotme letrare shqipe. Naimi u mundua edhe vetë që shqipja në poezitë e tij të shprehej në mënyrën më madhështore të mundshme

4.2 Vlera artistike e poezive

Vjershat e tij për fëmijë, fjalët e urta, dhe fabulat kanë temën e tyre edukuese dhe kjo është vlera artistike kryesore e tyre. Naimi synon t'i edukoj fëmijët me ndjenjat fisnike të dashurisë për gjuhën, atdheun, prindërit, shokët e të tjera. Ai në poezi preku vlerën diturore dhe morale duke u përpjekur për edukim e fëmijëve. Të thuhet se poezitë e tij për fëmijë janë tipike dhe përmbajnë të gjitha elementet e duhura mund të themi se jo. Këto poezi kanë shumë të meta, sepse nuk janë të shprehura mesazhet e tyre me anë të elementeve që i përkasin botës së

fëmijëve. Në to nuk kemi lojëra, nuk kemi figura që janë për botën e tyre përveç fabulave të cilat janë të ndërtuara me personazhet kafshë, por të cilat janë të ngjeshura për t'u kuptuar.

Po ashtu sa i përket anës strukturore shumica nga to janë në vargje, në veçanti disa nga fabulat që janë të ndërtuara në strofa ku bëjnë pjesë *Kunjadha veshur si këndesë*, *Të dy qetë dhe ujku* poezia *Bilbili* e të tjera. Në krijimet e tij poetike për fëmijë mesazhet janë shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për poezitë e tij për fëmijë mund të themi se kanë edhe vlerë historike sepse janë ndër të parat në gjuhën dhe letërsinë shqipe, gjë që i bën të veçanta dhe unike, edhe pse përmbajnë mangësitë e tyre në vete.

Naimi me letërsinë e tij për fëmijë ka vlerën më meritore sepse ka pasuruar këtë letërsi që në kohën e tij deri në ditët tona të shek XXI, sepse vepra e tij ka mbetur thesar i pashlyeshëm ndër dekata. Vlerë artistike kanë edhe fabulat e La Fontenit vlera e të cilave është origjinale sepse ato janë të përkthyer nga Naim Frashëri dhe janë të rëndësishme për letërsinë tonë shqipe.

KAPITULLI I PESTË

5. Mendime kritike për veprën e autorit

Naimi duke qenë figurë e rëndësishme në historinë e letërsisë shqipe nuk ka mbetur pa u kritikuar për punën e tij ndër shekuj.

Ta vlerësosh poezinë dhe veprën e tij në përgjithësi është sikur të kthehesh dhe të jetosh përsëri në kohën e tij, me shekuj prapa në histori. Për të ka kritika nga më të ndryshmet çoftë pozitive apo negative të cilat vazhdojnë edhe në ditët e sotme.

Prof. Eqrem Çabej:

“Poeti e ndjen veten të dërguar që me anë të fjalës së tij të zgjojë kombin nga gjumi i gjatë i shekujve. Rëndësia e tij qëndron kryesisht këtu, që ai në kohë të sundimit të huaj ndezi pishtarin e lirisë, që e hodhi këtë në literaturë dhe e mbajti ndezur ne dorë. Ai përmbushi detyrën që i pat caktuar vetes... ai i derdhi të gjitha fuqitë e tij mendore e fizike dhe në këtë punë shkriu veten në kuptimin e vërtetë të fjalës. Qiriri që ai këndon në një nga vjershat e tij, i cili digjet vetë për t’u ndritur të tjerëve, është një simbol i poetit vetë dhe i veprës së tij.”³⁶”

Prof. Rexhep Qosja:

“Nuk ka shkrimëtar shqipëtar që mund të na jetë gjuhësisht i afër aq sa na është Naim Frashëri. Krijimtarinë e asnjë shkrimtari shqiptarë deri në Luftën e Dytë Botërore lexuesit e sotëm shqiptarë nuk mund ta kuptojnë ashtu lehtë dhe ta përjetojnë estetikisht ashtu siç e kuptojnë dhe e përjetojnë krijimtarinë e Naim Frashërit. Pse? Sigurisht për arsyen se asnjë shkrimtarë shqiptarë tjetër deri në atë kohë nuk e shkruan gjuhën shqipe në mënyrë stilistikisht aq ndikuese dhe në një mënyrë historikisht parathënëse se ai.”³⁷”

³⁶<http://ëëë.gazetakritika.net/Forumi/index.php?itemid=5210>

³⁷Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Botime Toena, Tiranë, 2000, f.532,533.

Prof. Aristotel Mici:

“Po si edukator i kombit ai nuk mjaftohej vetëm me këshilla, po vriste mëndjen të ndihmonte konkretisht duke bërë libra diturakë për fëmijët e atëhershëm të Shqipërisë siç janë “Vjërshat për Mësonjëtoret e Para”, “ Këndimet e Çunave”, vjersha “Dituritë”, “Istori e përgjithshme”. Sot këto botime shkollore do të dukëshin didaktikë dhe miturake, por për në atë kohë, kur në Shqipëri kishte vetëm një shkollë shqipe dhe asnjë libër, rëndësia e tyre ka qënë e jashtëzakonshme. Përmes atyre teksteve të shkruara më një gjuhë të rrjedhëshme dhe të natyrëshme autori përpiqej të jepte mësimë edukative dhe informacoine shkencore. Me gjithë paraqitjen didaktike të atyre librave, ne, po të thellohemi në realitetin shqiptar të asaj kohe, gjejmë tek ato vepra edhe edukatorin, edhe dijetarin edhe artistin e fjalës, poetin e përkushtuar për gjithë çështjen kombëtare. E rëndësishme është të theksojmë me këtë rast se edhe nga ato tekste të thjeshta shkollore marim vesh mendimet përparimtare, që kishte përqaftuar autori. Naimi kishte një kuptim materialist për Universin, sistemin diellor dhe planete³⁸.”

³⁸<http://ëëë.gazetakritika.net/Forumi/index.php?itemid=5210>

Përfundimi

Nga i gjithë ky studim që u bë për poezinë për fëmijë të Naim Frashërit arritëm në përfundim se: Poezitë e tij janë të mbushura me vlerë në tematikën që trajtojnë, janë të tilla që po t'i lexosh gjatë gjithë kohës nuk ngopesh me to. Naim Frashëri me gjuhën e tij të thjeshtë e të pastër në vjershat e tij dëshmon për mjeshtërinë artistike të formimit të tyre. Moralin dhe diturinë ai i bëri elemente kryesore për zhvillimin intelektual të fëmijëve, po ashtu rëndësi të veçantë i dha atdheut duke e trajtuar atë e duke u munduar të zgjojë te fëmijët ndjenjën e madhe të patriotizmit poezia e tij ka rëndësi të veçantë për historinë e letërsisë shqipe, sepse ai hapi rrugën e nevojshme të krijimit të saj. Naimi ishte një shkrimtarë frymëzues, një mësues i popullit një personalitet që ndikoi me shkrimet e tij fuqishëm. Me poezitë e tij për fëmijë hapi një frymë të re e cila u përhap me shpejtësi dhe u lexua me adhurim të veçantë, gjithashtu me anë të saj letërsia shqipe hyri në një fazë më të lartë të zhvillimit.

Naimi figura qendrore e Rilindjes kombëtare, poezinë për fëmijë e ndërtoi në bazë të frymëzimeve personale të tij. Në disa prej fabulave duke përdorur alegorinë paraqet realitetin e hidhur të Shqipërisë, ndërsa me anë të figurës së epitetit i pasuroi artistikisht vjershat e tij. Talenti poetik edhe burimet e ndryshme më të cilat e ushqeu artin e tij poetik e bënë të mundshme që Naimi t'ia arrijë më së miri qëllimit e t'i jap popullit shkrime për fëmijët që do të lexohen për shekuj me radhë.

Prandaj, duke e përfunduar këtë punim, konstatojmë se Naim Frashëri shkriu jetën e tij, mendjen dhe zemrën e tij në krijimet e tij për të ndritur popullin shqiptarë. Vargjet e tij me një stil të lartë, me figuracion të pasur, me kuptim të ngërthyer në vete e bëjnë poezinë e tij për fëmijë tërheqëse dhe atraktive.³⁹

³⁹ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Botime Toena, Tiranë, 2000, në kopertinë.

Bibliografia (Literatura)

1. Bishqemi, Astrit, *Histori e letërsisë Shqiptare për fëmijë*, Sejko, Elbasan, 2004.
2. Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, *Historia e letërsisë shqipe I-II*, Prishtinë.
3. Frashëri, Naim, *Të vegjëlit*, Rilindja, Prishtë, 2001.
4. Frashëri, Naim, *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
5. Qosja, Rexhep, *Porosia e madhe*, Botime Toena, Tiranë, 2000.
6. Hamiti, Sabri, *Letërsia romantike shqiptare*, Botime shkollore Albas, Prishtinë, 2007.
7. Hamiti, Sabri, *Letra Shqipe*, Dukagjini, Pejë, 1996.
8. Hamiti, Sabri, *Letërsia filobiblike Letërsia Romantike*, Faik Konica, Prishtinë, 2002.
9. http://letersia.fajtori.com/Letersi/E_Rilindjes/Andon_Zako_Cajupi/naim_frasheri.php.
10. <http://ëëë.gazetakritika.net/Forumi/index.php?itemid=5210>